



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
THE MUNICIPALITY OF ASSEMBLY- SUHAREKA
SKUPSTINA OPSTINE-SUVA REKA



R R E G U L L O R E
PËR
MENAXHIMIN E MBETURINAVE NË
TERRITORIN E KOMUNËS SË SUHAREKËS

Suharekë-2026

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, pika (c), nenit 17, pika (f), nenit 40 paragrafi 2, pika (a) dhe (g), të Ligjit Nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008", e konform nenit 8, pika (a), nenit 15 pika (f) dhe nenin 19 paragrafi 1, të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 27/2008", i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin 05/L-108, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2016", e në mbështetje të nenit 15 dhe nenit 34, të Ligjit Nr. 04/L-060 për mbeturina "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 17/2012", i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-071 "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 29/2022", dhe dispozitat nenit 28, lidhur me nenin 29, të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, të datës 04.11.2008, e në zbatim të kërkesës për rishqyrtimin e aktit të lëshuar nga Ministria e mjedisit dhe planifikimit hapësinor Nr. 1799-2/26 të datës 27.04.2026, Kuvendi i Komunës së Suharekës, në mbledhjen e mbajtur më 29.05.2026, miratoi këtë:

R R E G U L L O R E **P Ë R** **MENAXHIMIN E MBETURINAVE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË** **SUHAREKËS**

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 **Qëllimi**

1.1 Kjo rregullore ka për qëllim që të rregulloj çështjen e menaxhimit të mbeturinave komunal dhe mbeturinat nga aktivitetet tjera, të natyrës së ngjashme me ato të amvisërisë, lartësinë e tarifës së taksës për menaxhimin e mbeturinave nga amvisëritë, mbeturinat komerciale apo industriale dhe mbeturinat institucionale me qëllim që të krijohet një sistem i qëndrueshëm, për administrimin financiar, ruajtjes së natyrës, ambientit jetësor dhe interesat tjera të përgjithshëm.

1.2 Aplikimi dhe shtrirja në funksion të sistemit për menaxhimin e qëndrueshëm të mbeturinave në pjesët urbane dhe rurale në gjithë territorin e Komunës së Suharekës, që nënkupton rregullat për grumbullimin, bartjen dhe vendosjen e mbeturinave për deponimi përfundimtar.

1.3 Me këtë rregullore po ashtu përcaktohet sistemi, orari dhe kushtet për mënyrën e grumbullimit të mbeturinave, vendosjen e kontejnerëve, mirëmbajtjen e vendeve ku grumbullohen ato dhe mënyra transportit të tyre.

Neni 2 **Fushëveprimi**

2.1 Kjo rregullore definon minimizimin e mbeturinave, ndarjen, ruajtjen, shkarkimin, grumbullimin, transportimin, aktivitetet e riciklimit dhe tarifë për mbeturina me qëllim të ruajtjes së mjedisit jetësor të shëndetshëm në juridiksionin e Komunës së Suharekës.

2.2 Dispozita e kësaj Rregullore janë obligative për të gjitha bizneset, kompanitë publike përgjegjëse për mbeturinat dhe operatorët tjerë, si dhe të gjithë atyre që kanë të bëjnë me mbeturina brenda territorit të Komunës së Suharekës.

Neni 3 Përkufizimet

- 3.1 **Mbeturina**- nënkupton substancë, apo objekt që prodhuesi ose zotëruesi e hedh ka për qëllim ta hedhë, apo është i detyruar ta hedhë.
- 3.2 **Menaxhim i mbeturinave**-nënkupton aktivitetet përfshirë mbledhjen, grumbullimin, transportin, përpunimin-rikuperimin, klasifikimin, deponimin e mbeturinave, mbikëqyrjen operacioneve të tilla dhe kujdesin, mirëmbajtjen e mëvonshme të vendeve të depozitimit, si dhe veprimet e ndërmarra nga një tregtar ose ndërmjetësues;
- 3.3 **Operator**-nënkupton personin e pajisur me leje përkatëse mjedisore i cili në përputhje me dispozitat e këtij ligji menaxhon, kontrollon, është përgjegjës për objektet dhe pajisjet e mbeturinave dhe është i autorizuar të marrë vendime në lidhje me funksionet ekonomike ose teknike të pajisjeve dhe objekteve.
- 3.4 **Leje përkatëse mjedisore**-nënkupton Leje mjedisore e integruar ose Leje mjedisore komunale, të përkufizuara sipas ligjit përkatës për mbrojtjen e mjedisit dhe Ligjit përkatës për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes;
- 3.5 **Person**-nënkupton Personin fizik ose juridik, i cili është i përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi në proceset për menaxhimin e mbeturinave.
- 3.6 **Ripërdorim**-nënkupton çfarë do operimi, me të cilin çdo produkt apo komponentë që nuk është mbeturinë dhe përdoret përsëri për të njëtin qëllim për të cilin është destinuar
- 3.7 **Mbledhje**-nënkupton mbledhjen dhe transportimin e mbeturinave duke përfshirë klasifikimin paraprak në lloje dhe magazinimin e mbeturinave për qëllime të bartjes deri në objektin për trajtim ose deponim të mbeturinave.
- 3.8 **Mbledhje e ndare**-nënkupton mbledhjen e mbeturinave kur grumbullimi i mbeturinave bëhet në mënyrë të ndarë në lloje, të klasifikuar sipas natyrës dhe pajisjeve për të lehtësuar trajtimin specifik
- 3.9 **Prodhuesi i mbeturinës**-nënkupton secilin person veprimtaria e të cilit krijon /prodhon mbeturinë, ose çdo njëri që merret me paraprocesim përzierje apo operime tjera që rezultojnë në ndryshimin e natyrës apo përbërjen e mbeturinës.
- 3.10 **Zotëruesi i mbeturinës**-nënkupton prodhuesin e mbeturinës apo personin që e zotëron mbeturinën.
- 3.11 **Mbeturina komunale**-nënkupton:
- 3.11.1 mbeturinat e përziera dhe mbeturinat shtëpiake të grumbulluara veç e veç, duke përfshirë letrën dhe kartuçin, qelqin, metalet, plastikën, mbetjet bio, drunjtë, tekstilet, paketimin, pajisjet e mbeturinave elektrike dhe elektronike, bateritë dhe akumulatorët e mbeturinave, mbeturinat vëllimore, përfshirë dyshekët dhe mobilitet;
- 3.11.2 mbeturinat e përziera dhe mbeturinat e grumbulluara veçmas nga burimet e tjera, kur mbeturinat e tilla janë të ngjashme në natyrë dhe përbërje me mbeturina shtëpiake.
- 3.11.3 mbeturinat komunale nuk përfshijnë mbeturinat nga prodhimi, bujqësia, pylltaria, peshkimi, tankerët septike dhe rrjetet e kanalizimeve, si dhe nga trajtimi i ujërave të zeza, duke përfshirë llumrat e ujërave të zeza, mbeturinat e automjeteve ose mbeturinat e ndërtimit.
- 3.12 **Mbeturina e parrezikshme**-nënkupton mbeturinat që nuk paraqesin rrezik për mjedisin dhe shëndetin e njeriut, dhe që nuk posedojnë karakteristika të mbeturinave të rrezikshme.
- 3.13 **Mbeturina komerciale**-nënkupton mbeturinat të cilat vijnë nga objektet që përdoren për qëllimet e tregut ose biznesit, sportit, edukimit, rekreacionit, por nuk përfshihen

mbeturinat industriale dhe që nënkuptohet çdo mbeturinë e prodhuar nga një biznes duke përfshirë por jo kufizuar, në letër, karton, kanaçe, paketim me pakicë dhe mbështjellës ushqimi

3.14 **Mbeturina inerte**-nënkupton mbeturinat që nuk kanë ndonjë ndryshim të rëndësishëm fizik, kimik apo biologjik në vendet ku janë deponuar si:

3.14.1 mbeturinat inerte që nuk treten, nuk ndizen ose nuk reagojnë fizikisht apo kimikisht, nuk zbërthehen biologjikisht në kontakt me materiet e tjera dhe nuk ndikojnë në mënyrë të ndjeshme në mjedisin dhe shëndetin e njeriut.

3.14.2 i tërë kullimi dhe përmbajtja ndotëse e mbeturinës, mbetjet ekotoksike duhet të jenë të vlerës së papërfillshme dhe të mos rrezikojnë cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore

3.15 **Mbeturinë e vëllimshme**-nënkupton mbeturinat me përmasa të mëdha fizike nga pajisjet dhe makineritë, grumbullimi, transportin dhe largim të cilave bëhet në mënyrë të veçantë.

3.16 **Mbeturina ushqimore** - nënkupton mbeturinat e çdo substance apo produkti, qofte i përpunuar, i përpunuar pjesërisht ose i papërpunuar, e që pritet të konsumohet nga njerëzit, pijet, çamçakëzët dhe çdo substance, përfshirë edhe ujin, të përfshirë qëllimisht në ushqim gjatë prodhimit, përgatitjes ose trajtimit të tij.

3.18 **Qendra grumbulluese**-nënkupton lokacionin për grumbullimin e mbeturinave të ndara sipas llojeve të përcaktuara.

3.19 **Deponi** – vend i caktuar dhe rregulluar për mbeturina, ku do të vendosen mbeturinat nën apo mbi sipërfaqe të tokës.

3.20 **Konsumator**- personi i cili ka lidhur kontratë për shërbime me ofruesin e shërbimeve ose merr shërbime të caktuara sipas ligjit.

3.21 **3R**-reduktim, ripërdorim dhe riciklim.

Neni 4

Llojit e mbeturinave

4.1 Llojet e mbeturinave të cilat i menaxhon Komuna në bazë të kësaj rregulloreje janë si në vijim:

4.1.1 Mbeturina komunale janë mbeturina nga amvisëritë, dhe mbeturina nga aktivitetet tjera të cilat për shkak të përbërjes dhe natyrës së tyre, janë të ngjashme me ato të amvisërisë në kuadër të cilat hyn.

4.1.2 Mbeturina inerte që nuk treten, nuk ndizen ose nuk reagojnë fizikisht apo kimikisht, nuk zbërthehen biologjikisht në kontakt me materiet tjera dhe nuk ndikojnë në mënyrë të ndjeshme në mjedisin dhe shëndetin e njeriut;

4.1.3 Mbeturina të vëllimshme - mbeturina me përmasa të mëdha fizike nga pajisjet e amvisërisë dhe mobilet.

4.1.4 Mbeturina nga konstruktimi-demolimet dhe mbeturinat tjera të gjeneruara nga aktivitetet ndërtimore;

4.1.5 Bio-mbeturinë janë mbeturinat biodegraduese nga kopshtet, parqet, ushqimet dhe mbeturinat e kuzhinës nga familjet, restorantet, objektet turistike, shitoret me pakicë dhe mbeturinat të ngjashme nga impiantet për përpunimin e ushqimit;

4.2 Mbeturina komerciale janë mbeturinat të cilat vijnë nga objektet që përdoren për qëllimet e tregut ose biznesit, sportit, edukimit, rekreacionit, por nuk përfshihen mbeturinat industrial.

4.3 Mbeturina industriale janë mbeturinat të cilat krijohen nga aktivitetet, proceset industriale, prodhimtari artizanale dhe veprimtari tjera prodhuese;

- 4.4 Mbeturina medicinal janë mbeturina patologjike të cilat krijohen nga aktiviteti medicinal, si dhe materialet e tjera që përdoren në shërbimet mjekësore;
- 4.5 Mbeturinat shtazore-janë mbeturina që krijohen nga amvisëritë, thertoret, mishtoret dhe aktivitetet e tjera të ngjashme.

Neni 5

Përrjashtimet

- 5.1 Nga kjo rregullore përjashtohen mbeturinat në vijim:
- 5.1.1 mbeturinat e rrezikshme dhe
 - 5.1.2 llumi/ balta dhe mbeturina të ngjashme
- 5.2 Menaxhimi i tyre rregullohet në bazë të akteve nënligjore të miratuar nga organi kompetent.

Neni 6

Përgjegjësia e Komunës për Menaxhimin e Mbeturinave

- 6.1. Krijimi i një sistemi të qëndrueshëm mbi menaxhimin e mbeturinave të ngurta komunale.
- 6.2. Krijimi i një sistemi të qëndrueshëm financiar.
- 6.3. Krijimi i procesit të kontraktimit për shërbimet e grumbullimit të mbeturinave.
- 6.4. Autorizimi i operatorit që të beje mbledhjen e mbeturinave e dhe jashtë orarit dhe dinamikës së paraparë, sipas nevojës
- 6.5 Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë në Komunën e Suharekës, monitoron dhe ofron udhëzime për ofruesit e shërbimeve për grumbullimin, transportimin dhe deponimin e mbeturinave, menaxhon me bazën e të dhënave të gjeneruesve të mbeturinave shtëpiake dhe vepron sipas planit komunal për menaxhimin e mbeturinave.
- 6.6 Të bëjë monitorimin mjedisor të deponisë së mbeturinave.
- 6.7 Të identifikoj pikat ilegale (të zeza) të hedhjes së mbeturinave dhe evitimi i tyre.
- 6.8 Promovimi për minimizimin e mbeturinave (3R, kompostimit shtëpiak etj.)
- 6.9 Promovimi i ngritjes së vetëdijesimit publik- pjesëmarrja aktive e qytetarëve në implementimin e menaxhimit të mbeturinave të ngurta.
- 6.10 Planifikimin buxhetor mbi funksionimin e menaxhimit të mbeturinave.
- 6.11 Përpilimi i raporteve, mbi menaxhimin e mbeturinave, dhe shkallën e inkasimit të tarifës mbi mbeturinat.
- 6.12 Formimi i komisionit në kuadër të administratës komunale, për shqyrtimin e ankesave dhe parashtrësive të taksapaguesve për mbeturina.
- 6.13 Propozon përcaktimin e tarifës dhe mënyrën e arkëtimit të mjeteve financiare për menaxhimin e mbeturinave, për miratim në Kuvendin e Komunës.
- 6.14 Dorëzimi i Raportit në Ministrin e Mjedisit dhe planifikimit Hapësinor, për MMN çdo 31 mars të vitit pasues.
- 6.15 Komuna ka përgjegjësi që të sigurojë kushte veprimi dhe operimi për operatorët publik dhe privat.
- 6.16 Trajtimi i mbeturinave nga ndërtimi dhe rrënimi, si dhe i mbeturinave inerte, komerciale, të vëllimshme brenda territorit të komunës
- 6.17 Hartimi i planit komunal për menaxhimin e mbeturinave (PKMM);
- 6.18 Të krijoj bazën e të dhënave me shënime për amvisëritë, bizneset dhe institucionet publike dhe private që pranojnë shërbime komunale të grumbullimit të mbeturinave, të cilat shënime

(apo regjistra) përmbajnë të dhënat për përdoruesit e shërbimeve, të dhënat personale, adresën si dhe të dhënat e tjera të nevojshme. Këto të dhëna duhet të përditësohen rregullisht nga ana e komunës, përkatësisht nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë.

6.19 Grumbullimin e mbeturinave të vëllimshëm komuna do ta bëjë së paku dy herë në vit, pa pagesë, sipas planit komunal për menaxhimin e mbeturinave.

6.19.1 java e parë e muajt maj (aksioni pranveror) dhe

6.19.2 java e parë e muajt nëntor (aksioni vjeshtor)

Neni 7

Sistemi i menaxhimit të mbeturinave komunale

7.1. Mbeturinat komunale duhet të mbledhen, transportohen, grumbullohen, trajtohen dhe menaxhohen në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturina edhe me Ligjin Nr. 08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-060 për mbeturina dhe me këtë Rregullore.

7.2. Komuna ofron sistemin e shërbimit të menaxhimit të mbeturinave përmes operatorëve të licencuar publik, privat apo publiko-privat.

7.3. Mbeturinat grumbullohen nga amvisëritë, institucionet, bizneset, hotelet, restaurantet dhe hapësirat publike, grumbullimi i këtyre mbeturinave do të ofrohet në shërbimin:

7.3.1. sistemi i grumbullimit derë më derë dhe

7.3.2 në pikat grumbulluese me kontejner-hapësira publike.

7.4. Komuna përmes Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencë, bën përzgjedhjen dhe caktimin e vendeve, pikave grumbulluese të mbeturinave, caktimin e hapësirave për ndërtim të qendrave të mëdha për grumbullim. Pikat grumbulluese caktohen sipas Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave.

7.5. Menaxhimi i mirë i mbeturinave nënkupton: mbulueshmëri me shërbim në tërë hapësirën komunale, shërbim të rregullt dhe cilësor. Standardet cilësore të menaxhimit të mbeturinave përcaktohen në Planin komunal për Menaxhimin e Mbeturinave (PKMM).

7.6. Ngritja e vetëdijesimit publik që ka për objektive ngritjen e vetëdijes shoqërore për menaxhimin e mbeturinave, puna me komunitet, palët e interesit, të gjitha institucionet edukativo-arsimore të cilat funksionojnë në territorin e komunës, duhet të edukojnë të gjithë qytetarët në përputhje me rregullat dhe ligjet përkatëse të trajtimit të mbeturinave.

Neni 8

Kategorizimi i gjeneruesve të mbeturinave

Gjeneruesit e mbeturinave kategorizohen si më poshtë:

8.1 Konsumatorët e amvisërive:

8.1.1 të shërbyer përmes kontejnerëve të përbashkët dhe

8.1.2 të shërbyer sipas shërbimit derë më derë

8.2 Konsumatorët komercialë/industrialë:

8.2.1 dyqanet e vogla zejtare dhe shërbyese

8.2.2 subjekte të mesme deri të mëdha komerciale me kosto të ulëta të shërbimit

- 8.2.3 subjekte të mesme deri të mëdha komerciale me kosto të lartë të shërbimit
- 8.3 **Konsumatorët Institucional:**
- 8.3.1 konsumatorët e vegjël institucionalë
- 8.3.2 konsumatorë e mesëm dhe të mëdhenj institucionalë
- 8.3.2 konsumatorët e mëdhenj institucionalë, të shërbyer me kontratë
- 8.4 Përshkrimi i detajuar i mëtejshëm i këtyre kategorive dhe taksave gjendet në shtojcën A si pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

Neni 9

Të drejtat dhe detyrat e gjeneruesve të mbeturinave

- 9.1. Çdo gjenerues i mbeturinave ka të drejtë qasje në shërbimin e grumbullimit të mbeturinave,
- 9.2. Të gjithë gjeneruesit e mbeturinave janë të obliguar të regjistrohen në bazën e të dhënave në Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë dhe të lidhin kontratën për shërbimin të gjeneruesit për mbledhjen dhe bartjen e mbeturinave.
- 9.3. Gjeneruesit e mbeturinave janë të obliguar që të paraqesin ndryshimet e të dhënave përmes kërkesës zyrtare (si p.sh adresën, shitjen e pronës, trashëgimia, dëshmi dhe dokumente të përditësuara etj), në bazën e të dhënave tek Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë.
- 9.4. Çdo gjenerues i mbeturinave ka të drejtë ankese, ndaj shërbimit të ofruar.
- 9.5. Çdo gjenerues i mbeturinave të ngurta duhet të respektoj rregullat e shkarkimit të përcaktuar sipas planit komunal të menaxhimit të mbeturinave.
- 9.6. Çdo gjenerues duhet të bëjë përpjekje për minimizimin e mbeturinave (përmes 3R, kompostimit shtëpiak dhe formave tjera të mundshme)
- 9.7. Për shërbimin e ofruar, gjeneruesi obligohet të paguaj tarifën e shërbimit.
- 9.8. Çdo gjenerues, duhet të bashkëpunoj me autoritetin publik, për të siguruar një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm.
- 9.9. Ndërmarrjet prodhuese, të cilat gjenerojnë mbeturina, obligohen që komunës së Suharekës t'ia dorëzojë planin e menaxhimit të mbeturinave, të cilat i gjenerojnë gjatë ushtrimit të veprimtarisë.
- 9.10. Gjeneruesit e mbeturinave obligohen që mbeturinat e tyre ti hedhin në vende të caktuara nga ana e Komunës për mbledhjen e mbeturinave ndërsa mbeturinat e rrezikshme, ti ndajnë dhe ti dorëzojnë në pikatë mbledhëse apo në vendet e caktuara nga Komuna.
- 9.11 Shërbimet e veçanta (largimi i mbeturinave të vëllimshme dhe mbeturinave të tjera që nuk largohen gjatë shërbimit të rregullt) bëhet me pagës, për veç shërbimeve sipas nenit 6 pika 19.
- 9.12 Bizneset të cilat ushtrojnë veprimtari të ndryshme janë të obliguar që ta mbajnë të pastër hapësirën para objektit dhe për rreth tyre.

Neni 10

Baza e të dhënave dhe regjistrimi i gjeneruesve të mbeturinave komunale

- 10.1 Komuna e Suharekës përmes Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencë dhe kompania rajonale e mbeturinave "Eko-Regjioni" njësia punuese në Suharekë, do të krijoj bazën e të dhënave për të gjithë gjeneruesit e mbeturinave komunale në territorin e kësaj komune, duke e respektuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-082- Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale sipas nenit 5 paragrafi 1.5.
- 10.2 Baza e të dhënave do të regjistroj të dhënat personale të gjeneruesve, përcaktimin e llojit të mbeturinave nga gjeneruesit, kategorizimin e gjeneruesve, shumën e faturimit të tarifës dhe

shumën e inkasimit të tarifës për grumbullimin e mbeturinave, me qëllim të interesit publik për implementimin e planit për menaxhimin efikas të mbeturinave komunale.

10.3 Përgjegjësi e menaxhimit, përditësimit dhe mirëmbajtjes së bazës së të dhënave i takon Komunës së Suharekës përmes Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencë dhe kompanisë rajonale të mbeturinave “Eko-Regjioni” njësia punuese në Suharekë.

10.4 Regjistrimi i gjeneruesve të mbeturinave komunale, bëhet me paraqitjen e këtyre dokumenteve:

- 10.4.1 dokumentin identifikues (letërnjoftimi, pasaporta)
- 10.4.2 dokumentet e regjistrimit për personat juridik (certifikata e biznesit ose akt themelimi etj.)
- 10.4.3 dëshmi- njehsorin e rrymës elektrike;
- 10.4.4 dëshmi mbi regjistrimin e objektit në tatimin në pronë;
- 10.4.5 dëshmi e pagesës së faturës për mbeturina në adresën ku ka banuar më parë (në rastet kur gjeneruesi e ndërron adresën e banimit)
- 10.4.6 dëshmi të certifikatës familjare (për kategorizim të faturës së tarifës në individë/familje)
- 10.4.7 në rastet e shitblerjes së objekteve, shitësi dhe blerësi duhet të kenë të paguar borxhin paraprak për mbeturinat në tërësi dhe të paraqesin kontratën e shitblerjes, për të i bërë ndryshimet në data bazë dhe në faturim.

10.5. Gjeneruesit të cilët posedojnë dy apo më shumë fatura të tarifës për mbeturina, për objekte banimi aktive, duhet të lajmërohen para organit komunal, respektivisht SMM për kategorizimin e ngarkesës së faturës.

10.6 Sipas paragrafit 4, të këtij neni, kategorizimi në ngarkesë të faturës nënkupton:

10.6.1 kategoria e parë: amvisëritë rezidenciale (vendbanimi i përhershëm);

10.6.2 kategoria dytë: amvisëritë jo rezidenciale (amvisëritë me vendbanim të përkohshme që jetojnë jashtë territorit të Komunës së Suharekës, të dëshmuar me kartelën vjetore të harxhimeve të energjisë elektrike

10.6.3 kategoria e tretë: amvisëritë pasive (shtëpi apo objektet e banimit të cilat janë të pabanuara por që pranojnë faturë për mbeturina) duhet të dëshmojnë me kartelën vjetore të harxhimeve të energjisë elektrike;

10.6.4 kategoria katërt: amvisëritë të tjera që nuk përfshihen kategoritë më të larta;

10.7 Në rastet e dyfishimit të faturave për të njëjtin gjenerues, anulohet/fshihen faturat nga baza e të dhënave për menaxhimin e mbeturinave nëse ofrojnë dëshmi të mjaftueshme.

10.8 Çdo amvisëri që banon me qira është e obliguar të bëjë pagesën për mbeturina në emrin e vetë dhe duhet të regjistrohet në bazën e të dhënave për menaxhimin e mbeturinave, ose të dëshmojë kontratën e nënshkruar qiradhënës dhe qiramarrës për banim.

Neni 11

Përcaktimi i tarifës për grumbullimin e mbeturinave komunale

11.1. Tarifa për mbeturinat komunale për amvisëri apo individë, komerciale apo industriale dhe institucionale, faturohen dhe inkasohen nga kompania rajonale e mbeturinave “Eko-Regjioni” njësia punuese në Suharekë, faturimi i tarifës së mbeturinave bëhet në bazë mujore, kurse fatura i dorëzohet gjeneruesit të mbeturinave, më së largu deri me datën 10, të muajit pasues dhe pagesa nga gjeneruesi bëhet direkt kompanisë rajonale të mbeturinave “Eko-Regjioni” njësia punuese në Suharekë.

11.2. Në përcaktimin e tarifës për grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave të amvisërisë duhet të merren parasysh këto elemente ndikuese:

11.2.1 Shpenzimet operative te grumbullimit të mbeturinave (transporti, mirëmbajtja e mjeteve transportuese, burimet njerëzore etj)

11.2.2 Tarifa e pranimit nga deponia e mbeturinave.

11.2.3 Elementet tjera të ndikueshme nga aspekti ekonomik dhe ndikuesit tjerë për menaxhimin sa me efikas të mbeturinave.

11.3. Gjeneruesi i mbeturinave obligohet që të paguajë faturën e tarifës së mbeturinave për çdo muaj të vitit si dhe në këste, nga 3 mujore brenda vitit, si më poshtë:

11.3.1 Kësti parë Janar - Mars

11.3.2 Kësti i dyte Prill - Qershor

11.3.3 Kësti i tretë Korrik- Shtator

11.3.4 Kësti i katërt Tetor-Dhjetor

11.4 Pagesa e tarifës për mbeturina bëhet në institucionet financiare për pagesa, në llogarinë bankare përkatëse të kompanisë rajonale të mbeturinave “Eko-Regjioni” njësia punuese në Suharekë.

11.5 Çdo person fizik apo juridik i cili për një periudhë të caktuar kohore nuk ka nevojë të marr shërbim të grumbullimit të mbeturinave, duhet të njoftoj paraprakisht me kërkesë Drejtorinë për Shërbime Publike dhe Emergjencë në Komunën e Suharekës si dhe kompanisë rajonale të mbeturinave “Eko-Regjioni” njësia punuese në Suharekë dhe duhet të bashkëngjis këto dokumente:

11.5.1 dëshmi faturën mbi shpenzimin e rrymë;

11.5.2 dëshmi faturën mbi shpenzimin e ujit;

11.6 Një pronë mund të konsiderohet e pashfrytëzuar nëse për një periudhë prej 3 muaj nuk ka shpenzuar rrym më shumë se 40kw në muaj si dhe shpenzime të ujit jo më shumë se 1m³ në muaj.

11.7 Lirimi nga pagesa do të bëhet në mënyrë retroaktive, pas paraqitjes së kërkesës me dokumentet e kërkuar në pikën 11.5 të këtij neni.

Neni 12

Tarifa mbi mbeturinat komunale të amvisërisë

12.1 Fatura e tarifës komunale për mbeturinat komunale i lëshohet çdo kryefamiljari, individi dhe personave fizik dhe juridik.

12.2 Tarifa komunale e mbeturinave shtëpiake ndahet në tre kategori, në:

12.2.1 tarifa e mbeturinave shtëpiake për banorët rezidentë/komunal/individë: 12, muaj

12.2.2 tarifa e mbeturinave shtëpiake për banorët rezidentë/komunal/familje: 12 muaj

12.2.3 tarifa e mbeturinave shtëpiake për banorët jorezident/diaspora/familje: 12 muaj

12.4 Tarifa për mbeturinat komunale për konsumatorët komercial, industrial dhe institucionale kategorizohet dhe përcaktohet ne shtojcën A të kësaj rregullore e cila është pjesë përbërës.

Neni 13

Obligimi i pagesës së tarifës për mbeturinat

13.1 Të gjithë gjeneruesit të cilët marrin shërbim mbi grumbullimin e mbeturinave dhe janë te regjistruar në bazën e të dhënave, detyrohen të paguajë tarifën. Nëse gjeneruesi i mbeturinave nuk i paguan 2, (dy) këste të njëpasnjëshme (janar-mars dhe prill-qershor), ndaj secilit gjenerues

do të iniciohet procedure e përmbarimit tek përmbaruesit privat për pagese të detyrueshme të borxhit.

13.2. Shkalla e tarifës do të rishikohet çdo dy vjet nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë-Sektori i menaxhimit të mbeturinave, duke marr parasysh performancën e shkallës së inkasimit, etj.

13.3 Kur Kuvendi Komunal në Suharekë miraton shkallën e përshtatshme të propozuar për vitin në vijim, njoftohen qytetarët para vitit të ardhshëm fiskal.

13.4 Tarifa minimale e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave tu ofrohet institucioneve dhe bizneseve të mëdha, të kontraktohen individualisht siç edhe është përcaktuar për të ruajtur kualitetin e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave.

Neni 14

Detyrat dhe Përgjegjësit e Operatorëve të kontraktuar për Shërbimin e Mbeturinave

14.1 Operatori i kontraktuar nga organi kontraktues, për ofrimin e shërbimeve për menaxhimin e mbeturinave duhet të jetë i pajisur me leje dhe është i obliguar që të veproj sipas kontratës, ligjeve në fuqi dhe kësaj rregulloreje.

14.2 Operatori i kontraktuar është obliguar që të raportoj për çdo muaj për shërbimet kontraktuese si dhe ta dorëzoj raportin vjetor deri në fund të muajt shkurt të vitit kalendarik në sektorin për menaxhimin e mbeturinave (SMM).

Neni 15

Veprimet e ndaluara

15.1 Në bazë të kësaj rregulloreje ndalohen veprimet si më poshtë nëse;

15.1.1 hedhë cigaren në rrugë ose në sipërfaqe publike;

15.1.2 hedhë çamçakëz në rrugë ose në sipërfaqe publike;

15.1.3 hedhë ambalazhe dhe mbeturina letre në rrugë ose në sipërfaqe publike;

15.1.4 hedhë ambalazhe dhe mbeturina plastike në rrugë ose në sipërfaqe publike;

15.1.5 hedhë ambalazhe dhe mbeturina qelqi dhe metali në rrugë ose në sipërfaqe publike;

15.1.6 hedhë kanaçe në rrugë ose në sipërfaqe publike;

15.1.7 hedhë mbeturina ushqimore në rrugë ose në sipërfaqe publike;

15.1.8 hedhë çfarëdo lloj mbeturine në rrugë ose në sipërfaqe publike;

15.1.9 hedhë mbeturina komunale jashtë kontejnerit për mbeturina komunale;

15.1.10 në kontejner të mbeturinave, merr ose shkapërderdh-nxjerr mbeturina prej kontejnerit jashtë;

15.1.11 hedhë mbeturina të përziera në kontejnerët ku janë të klasifikuara mbeturinat si;

15.1.11.1 organike, qelqi, letra, plastika, metali,

15.1.11.2 mbeturinat nga copëtimi dhe prerja i drunjtëve, i lenë në rrugë ose në sipërfaqe publike;

15.1.11.3 mbeturinat nga thëngjilli, i len në rrugë ose në sipërfaqe publike;

15.1.11.4 nuk e pastron jashtëqitjen e kafshës së tyre në rrugë, trotuare, parkingje, objekte të banimit kolektiv, hapësira dhe objekte tjera publike;

15.1.12 hedhë cigare në rrugë nga automjeti në lëvizje;

15.1.13 hedhë ambalazhe dhe mbeturina letre në rrugë nga automjeti në lëvizje;

15.1.14 hedhë ambalazhe dhe mbeturina plastike në rrugë nga automjeti në lëvizje;

15.1.15 hedhë ambalazhe dhe mbeturinë qelqi në rrugë nga automjeti në lëvizje;

15.1.16 hedhë kanaçe në rrugë nga automjeti në lëvizje;

15.1.17 hedhë mbeturina ushqimore në rrugë nga automjeti në lëvizje;

- 15.1.18 dëmton kontejnerët për mbeturina komunale;
- 15.1.19 i ndërron vendin kontejnerëve për mbeturina komunale;
- 15.1.20 hedhë akumulatorë në kontejnerët për mbeturina komunale;
- 15.1.21 hedhë pajisje elektrike dhe elektronike në kontejnerët për mbeturina komunale;
- 15.1.22 hedhë mbeturina të automjeteve të vjetra në kontejnerët për mbeturina komunale, rrugë, në natyrë dhe sipërfaqe publike;
- 15.1.23 hedhë ambalazhe dhe mbeturina letre në natyrë;
- 15.1.24 hedhë ambalazhe dhe mbeturina plastike në natyrë;
- 15.1.25 hedhë ambalazhe dhe mbeturina qelqi në natyrë;
- 15.1.26 hedhë kanaçe në natyrë;
- 15.1.27 hedhë mbeturina ushqimore në natyrë;
- 15.1.28 hedhë mbeturina nga kopshtet në kontejnerët për mbeturina komunale;
- 15.1.29 hedhë çfarëdo lloj mbeturin nga ballkoni ose dritarja e objektit;
- 15.1.30 hedhë mbeturina në pusetat për kanalizim;
- 15.1.31 hedhë mbeturina nga ambalazha e materialit ndërtimor jashtë kontejnerëve (ambalazhë letre, metal, plastike dhe materiale të ndryshme);
- 15.1.32 hedhë mbeturina të ngjyrave në kanalizim;
- 15.1.33 hedhë mbeturina të ngjyrave në kontejner për mbeturina komunale;
- 15.1.34 hedhë mbeturina të vajit në tokë nga pakujdesia;
- 15.1.35 hedhë mbeturinat medicinale në kontejner për mbeturina komunale;
- 15.1.36 hedhë mbeturina të stallave në afërsi të rrugës brenda vendbanimit (nuk nënkupton shpërndarjen e plehut në ara);
- 15.1.37 hedhë mbeturina në pronën e tjetrit;
- 15.1.38 hedhë pajisje elektrike dhe elektronike në sipërfaqe publike ose në natyrë;
- 15.1.39 hedhë bateri ose akumulator në sipërfaqe publike ose në natyrë;
- 15.1.40 hedhë cigaren e ndezur në kontejnerin për mbeturina komunale;
- 15.1.41 hedhë hiri në kontejnerin për mbeturina komunale;
- 15.1.42 hedhë mbeturina nga materialet ndërtimore jashtë vendeve ose kontejnerëve të caktuar nga autoriteti komunal për mbeturina të materialeve ndërtimore;
- 15.1.43 hedhë mbeturina nga materialet ndërtimore në kontejnerët për mbeturina komunale;
- 15.1.44 hedhë mbeturina medicinale në sipërfaqe publike ose në natyrë;
- 15.1.45 hedhë mbeturina medicinale jashtë kontejnerëve për këto lloje të mbeturinave;
- 15.1.46 hedhë mbeturina të vëllimshme në kontejner për mbeturina komunale, sipërfaqe publike ose në natyrë;
- 15.1.47 hedhë lloj tjetër të mbeturinave në sipërfaqe publike ose në natyrë;
- 15.1.48 hedhë mbeturina të përziera me vaj në kontejnerët për mbeturina komunale;
- 15.1.49 mbeturinat drunore nga krasitja e bimëve ose drunjëve nuk i mbledh nga rruga ose hapësira publike në kohën e krasitjes;
- 15.1.50 hedhë mbeturina drunore nga krasitja e bimëve ose drunjëve në kontejnerët për mbeturina komunale;
- 15.1.51 djegë mbeturina komunale në kontejner;
- 15.1.52 hedhë broshura, fletëpalosje jashtë vendeve të përcaktuara nga komuna;
- 15.1.53 hedhë çfarëdo lloj mbeturine në ujëra të përroskave, lumenjve, liqeneve ose sipërfaqeve të tjera me ujë;
- 15.1.54 hedhë çfarëdo lloj mbeturine në brigjet e përroskave, lumenjve, liqeneve ose sipërfaqeve të tjera me ujë;
- 15.1.55 hedhë mbeturina të vajit në sipërfaqe publike, kanalizim, në rrugë ose në natyrë;
- 15.1.56 hedhë mbeturina të përziera me vaj në sipërfaqe publike, në rrugë ose në natyrë;

- 15.1.57 hedhë mbeturina të gomës dhe goma të automjeteve në sipërfaqe publike, në rrugë ose në natyrë;
- 15.1.58 djegë mbeturina komunale në sipërfaqe publike, në rrugë ose në natyrë;
- 15.1.59 djegë goma, goma të automjeteve ose mbeturina tjera prej gome, në hapësira private, publike, në rrugë ose në natyrë;
- 15.1.60 djegë mbeturina të ndryshme prej plastike, në hapësira private, publike, në rrugë ose në natyrë;
- 15.1.61 djegë mbeturina të ndryshme prej letre në sipërfaqe publike, në rrugë ose në natyrë;
- 15.1.62 djegë vajra ose mbeturina të vajrave në hapësira private, publike, në rrugë ose në natyrë;
- 15.1.63 djegë mbeturinat të ndryshme në sipërfaqet e tokave bujqësore;
- 15.1.64 derdhë çfarëdo materiali në sipërfaqe publike, në rrugë ose në natyrë me ç 'rast prej saj krijohet mbeturinë ose ndotje

Neni 16

Dispozitat Ndëshkuese –Gjobat

- 16.1 Ndaj gjeneruesit të mbeturinave, i cili nuk e bën pagesën e taksës për mbeturina do të iniciohet procedurë gjyqësore në gjykatën kompetente ose me procedura përmes përmbauesve privatë.
- 16.2 Çdo person fizik apo juridik i cili shkel dispozitat e neneve të kësaj Rregullore kryen kundërvajtje dhe do të ndëshkohet, sipas Ligjit Nr. 08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-060 për mbeturina.
- 16.3 Për shkelësit e dispozitave të kësaj rregulloreje, për veprimet e ndaluara sipas nenit 15, inspektori komunal, inspektori mjedisit dhe policia e Kosovës, shqipton gjobë mandatorë sipas, Ligjit Nr. 08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-060 për mbeturina.
- 16.4 Pala e pakënaqur kundër vendimit të inspektoratit, ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të vendimit, në pajtim me rregullat e Ligjit përkatës për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 17

Mbikëqyrja

Për zbatimin e kësaj rregulloreje janë kompetente Kryetari i Komunës, Drejtoria Inspektoratit dhe Drejtoria për shërbime publike dhe emergjencë si dhe organet komunal përkatës, si dhe Policia e Kosovës.

Neni 18

Epërsia me Ligjet dhe aktet tjera nënligjore

Në raste konflikti dhe mos përputhje të dispozitave të kësaj Rregullore dhe dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-060 për mbeturina “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 17/2012”, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-060 për mbeturina “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 29/2022”, do të aplikohen dispozitat e ligjit dhe akteve tjera nënligjore, të cekura më lart, ndërsa dispozitat përkatëse të kësaj Rregullore konsiderohen të revokuara.

Neni 19
Propozimi për ndryshimin dhe plotësimin

Kjo rregullore mundë të ndryshohet dhe plotësohet në procedurë të njëjtë me atë të miratimit nga Kuvendi i Komunës në Suharekë, me propozimet e arsyetuare nga propozuesi.

Neni 20
Hyrja në fuqi

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, kjo Rregullore hyn në fuqi 30, ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me neni 9, të Ligjit Nr. 08/L-284, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, publikuar në "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 24/2024" dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, (QRK) Nr. 03/2026, për procedurat e shqyrtimit administrativ të akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen zyrtare të Komunës.

Neni 21
Zbatimi

Kjo rregullore fillon të zbatohet-implementohet nga 01 korrik i vitit 2026 dhe e shfuqizon Rregulloren për menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Suharekës, 01-Nr-110-18191 e datës 21.05.2020.

KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr-016-24512
Me data 29.05.2026



Kryesuesi i Kuvendit

Mr.ec/Bexhet KUÇI

SHTOJCA A: Tarifa e taksës për mbeturina;**Ç M I M O R E****LISTA E KONSUMATOREVE PËR SHËRBIMET E GRUMBULLIMIT TË MBETURINAVE (MUJORE) PËR VITIN 2026****I. Kategoria amvisëri :** *Shërbimi derë-më derë dhe me kontejnerë të përbashkët*

Tarifat mujore	Tarifa 7.50 € / njësi familjare 4.50 € / individë
Kategoritë	Amvisëri jo rezident (diaspora) 3.00 € / njësi familjare për muaj

II. KATEGORIA E KONSUMATOREVE KOMERCIAL / INDUSTRIAL: *Shërbimi derë-më derë dhe me kontejnerë të përbashkët*

Zona e Parë	Zona e dytë	Zona e tretë
Suharekë	Sopijë	Stravuçin
Shirokë	Savrovë	Krushicë e ulët
Reshtan	Bukosh	Budakovë
	Vraniq	Krushicë e epërme
	Reqan	Mohlan
	Mushtisht	Doberdelan
	Dubravë	Nishor
	Sallagrazhd	Kasterc
	Grejkoc	Populan
	Gjinoc	Maqitevë
	Gelancë	Papaz
	Leshan	Vërshec
	Tërmje	Qadrak
	Nepërbisht	Grejqevc
	Samadrexhë	Luzhnicë
	Studenqan	Breshanc
	Peqan	Delloc
	Bukosh	Dvoran
	Bllacë	
	Duhël	
	Semetisht	
	Sllapuzhan	

I. Tarifa mujore	II. Tarifa mujore	III. Tarifa mujore	IV. Tarifa mujore	V. Tarifa mujore
Zona A: 9.00 € Zona B: 8.00 € Zona C: 6.00 €	Zona A: 10.00 € Zona B: 8.00 € Zona C: 6.00 €	Zona A: 13.00 € Zona B: 10.00 € Zona C: 9.00 €	Zona A: 16.00 € Zona B: 15.00 € Zona C: 10.00 €	Zona A: 30.00 € Zona B: 20.00 € Zona C: 15.00 €
Avokaturat Zyre tjera Agjencionet Bizhuteritë Argjendarit Optika Çajtoret Kozmetikët Këpucëtarët Ortarët Farkëtarët Kafe pjekësit Video lojërat Kurse e gjuhëve Kiosqet Fotografisë Auto parkingjet Auto larjet Rrobaqepëse Këmbimorët	Kompanitë sigurimeve Auto shkollat Frizerët Mobil shop Kompjuter shop Auto elektrikist Auto mekanik Auto veglat Barnatore bujqësore Auto pjesë Librarit Elektro material Vulkanizer Bastoret Hekurishtet Zdrukthëtarët Serëvis teknikes bardh Parkingjet	Butikët Barnatoret Dyqanet e këpucëve Sanitarit Laboratorët Minimarket Dyqanet Tekstil Sallonet e perdeve Sallone teknike bardh Pllacet ndërtimore	Kafiterit Ëmbëltoret Qebaptoret Byrektoret Gjellëtoret Piceritë Marketet Motelet Pompë benzinës (vetëm pompë) Sallonet e tepihëve Mobilierit Ordinancat Depot e pijeve Depot ushqimore	Restorantet Hotelet Furrat Pompa Benzinës –me objekt përcjellës
Çmimet sipas zbrazjeve				
Vëllimi i Kontinerit	1.1 m ³	5.0 m ³	7.0 m ³	
Tarifa (Euro/zbrazje)	15.00 €	57.00 €	67.00 €	

Vërejtje: kontejneri 1.1 m³ x 80.00 euro për një zbrazje është për mishtore dhe xhampresa.

III. Kategoria e konsumatorëve Institucional.

Tarifa mujore 10.00 €	Tarifa mujore 18.00 €	Tarifa mujore 35.00 €	Tarifat mujore 1 kontejnerë 1.1 m³ (51.00 €)
Zyre e partive Politike, Përfaqësitë të shoqatave, Objekte fetare	Teatër Galeri e arteve Biblioteka Çerdhe dhe te ngjashme	Bankat Mikro financat Institucionet Financiar Zyre postare Keds Kost Hidroregjioni Të ngjashme	Objektet Komunale QKMF-ja Poliklinikat specialistike Ambulancat Shkollat Gjykatat Posta Policia Qendra regjistrimit (QKRC) Stacioni autobusëve Salla sportive
Shërbimet e ofruara me kontejnerë të veçantë			
Vëllimi i kontejnerit	1.1 m ³	5.0 m ³	7.0 m ³
Tarifa (euro/zbrazje)	20.00 €	57.00 €	67.00 €